



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.448/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjore Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, Shkodran Sogojeva nga fshati Grabovc, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e palejuar ankesa ZL.A.nr.448/2017, i kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, Shkodran Sogojeva, e paraqitur me datën 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

### A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Shkodran Sogojeva, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovë, me të cilën veprim ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi formularë të vendvotimeve, pra i njëjti nuk ka pretenduar asgjë lidhur me këtë ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë përkitazi me pa rregullsit e votave, për shkak të pa rregullsive, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Shkodran Sogojeva, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr.448/2017 më datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
Zyheri Haziri



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*